

Informacion për Visa Airport Companion (VAC)

Union Bank dhe Visa vazhdojnë të sigurojnë eksperiencën më të mirë dixhitale për kartëmbajtësit e kartave të kreditit Visa Platinum, nëpërmjet ofrimit të pagesave të shpejta dhe të sigurta dhe në të njëjtën kohë aksesimit falas të zonave të biznesit në aeroporte të ndryshme në të gjithë botën.

Aksesimi i Zonave të biznesit në aeroporte është pjesë e privilegjeve që Karta e Kreditit Visa Platinum ofron, dhe në të njëjtën kohë dhe një eksperiencë unike si kartëmbajtës të kësaj karte.

Për këtë arsye prezantojmë Aplikacionin Visa Airport Companion.

Ky aplikacion pasi shkarkohet nga klienti, i jep mundësi user-it të regjistrojë të dhënat e kartës fizike në platformën dixhitale, nëpërmjet të cilës eksplorohehen dhe përzgjidhen zonat e biznesit në çdo aeroport të listuar në aplikacion.

Duke filluar nga data 1 Tetor 2024 aksesimi i zonave të biznesit në aeroporte për të gjithë kartëmbajtësit e Kartave Visa Platinum nga Union Bank, do të mund të kryhet vetëm nëpërmjet aplikacionit Visa Airport Companion. Pas kësaj date anëtarësimet e mëparshme nuk do të transferohen dhe nuk do të jenë më të vlefshme. Union Bank & Visa do të vazhdojnë të ofrojnë standardin më të lartë të aksesit në lounge-t e aeroportit, të disponueshme për mbajtësit e kartave Visa Premium në të gjithë botën. Nga data 9 Tetor 2025, Visa aplikon Autorizimin 0\$ si pjesë e "Aplikacionin Visa Airport Companion" për të gjithë kartëmbajtësit me Kartën e kreditit Visa Platinum, nëpërmjet të cilës bëhet një verifikim nëse karta është aktive. Nga ky verifikim do të jenë të vlefshme për të aksesuar Lounge tek aeroportet partnerë, vetëm kartat aktive.

Kush duhet të shkarkojë aplikacionin Visa Airport Companion

Të gjithë kartëmbajtësit që disponojnë Kartën e kreditit Visa Platinum dhe që në udhëtimet e tyre dëshirojnë të aksesojnë zonat e biznesit në Aeroportet partnere.

- **Si shkarkohet Visa Airport Companion?**

Ky aplikacion shkarkohet në çdo pajisje Android apo iOS.

- **Ç'farë ofron ky shërbim?**

Me aplikacionin Visa Airport Companion, kartëmbajtësit e Kartave të Kreditit Visa Platinum duhet të regjistrojnë të dhënat e kërkuara në aplikacion, për të aksesuar privilegjet në zonat e biznesit të lidhura me kartën e tyre. Ata gjithashtu mund të informohen për zonat e biznesit në aeroportet që kanë akses, të kontrollojnë aksesin e tyre të mbetur vjetor dhe të përcaktojnë kualifikimin e mëtejshëm ose aksesin shtesë.

- **A ka komision përdorimi i aplikacionit Visa Airport Companion?**

Ky aplikacion aksesohet falas, dhe nuk paguhet asnjë komision shtesë.

- **Si kryhet regjistrimi dhe hyrja në aplikacion?**

1. Klienti shkarkon aplikacionin Visa Airport Companion
2. Përzgjidhet Sign Up për tu regjistruar ose Sign In për të hyrë në aplikacion
3. Aplikacioni njofton kartëmbajtësit që gjatë regjistrimit do ti kërkohen të dhëna mbi kartën, dhe pse nevojiten ato.
4. Plotësohen të dhënat e kartës që kërkohen në aplikacion
5. Përzgjidhet shteti në të cilin është lëshuar karta
6. Vendoset kodi që dërgohet në telefonin e kartëmbajtësit për të kryer verifikimet e kërkuara
7. Vendosen të dhënat personale dhe mënyrat e kontaktit
8. Dakortësohet mbi kushtet dhe termat e aplikacionit

Informacion për Visa Airport Companion (VAC)

9. Vendoset kodi 6-shifror që dërgohet në adresën e e-mailit të kartëmbajtësit
10. Krijohet një password i cili do të përdoret për të hyrë në aplikacion

- **Ç'farë ofron Visa Airport Companion**

1. Informacionin mbi Zonat e biznesit (Business Lounge) dhe Aeroportet partnere në të gjithë botën

2. Gjetja e Zonës së Biznesit që do të aksesohet duke klikuar butonin “Walk In.”
3. Aksesimi i anëtarësimi dixhital “Membership Button”, dhe hyrja në Zonën e Biznesit
4. Informacion mbi aksesin e mbetur vjetor mbi hyrjet në zonat e Biznesit në Aeroport.

Si kryhet hyrja në Zonat e biznesit në Aeroport?

1. Shkarkohet aplikacionin Visa Airport Companion, të disponueshëm për Android dhe iOS.



2. Kryhet regjistrimi duke plotësuar të dhënat e kërkuara në aplikacion
3. Identifikohet Zona e Biznesit specifike që dëshirohet të përdoret dhe klikohet “Walk In”



4. Klikohet për të marrë akses digjital



Për të hyrë në Zonën Lounge, duhet ta skanoni atë në stendën në hyrje gjatë hyrjes në Zonën e Biznesit në Aeroport.

Për të aksesuar aplikacionin Visa Airport Companion kërkohet Internet? Jo.

Ky aplikacion mund të aksesohet edhe pa patur internet.

A ka një limit në numrin e hyrjeve në Zonat e Biznesit në Aeroporte?

Me Kartën e Kreditit Visa Platinum ofrohen **10 hyrje**¹ në vit në të gjitha aeroportet partnere. Numri i hyrjeve në Lounge është i vlefshëm për periudhën **26 Maj 2025** deri **26 Maj 2026**.

Ftojme të gjithë klientët kartëmbajtës me Kartë Krediti Visa Platinum të përdorin këtë ofertë brenda kësaj periudhe duke ndjekur instruksionet më sipër!

¹ Ky përfitim është i vlefshëm vetëm për karta aktive Visa Platinum (përfshihen kartat e bllokuara, inaktive apo të humbura)